

URDHËR
Nr. 565, datë 23.12.2021

**PËR NJË SHITESË DHE DISA NDRYSHIME NË URDHURIN NR. 53, DATË
31.1.2020, “PËR NGRITJEN E KOMITETIT TË PËRKOHSHËM PËR INFEKSIONIN
E PËRHAPUR NGA CORONAVIRUS I RI”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të nenit 33, germa “ë”, të ligjit nr. 15, datë 10.3.2016, “Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

Në urdhrin nr. 53, datë 31.1.2020, “Për ngritjen e komitetit të përkohshëm për infeksionin e përhapur nga Coronavirus i ri”, të ndryshuar, bëhet shtesa dhe ndryshimet si vijon:

1. Në pikën 2 të urdhrin:

a) Germa “c” riformulohet si vijon:

“c) znj. Albana Fico, drejtor, QSUT, anëtar”.

b) Pas germës “m” shtohet germa “n” me këtë përmbajtje:

“m) znj. Eugena Tomini, drejtor, ISHP, anëtar”.

2. Pika 3 ndryshon si vijon :

“3. Sekretar i Komitetit të përkohshëm për infeksionin e përhapur nga Coronavirus i ri është znj. Elona Kureta, nga Instituti i Shëndetit Publik”.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE
Ogerta Manastirliu